

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKTA E APELIT E KOSOVËS- Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët, Tonka Berishaj kryetare e kolegjit, Have Haliti dhe Fillim Skoro, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Perparim Zeka si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Xh.Xh. nga fsh. ..., Komuna e Vitisë, për shkak të veprës penale, keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit av. E.V., të paraqitur kundër aktgjykimi të Gjykatës Themelore DRK në Gjilan, PKR.nr.292/2016 të datë 02.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur, konform nenit 390 par.1 të KPPK- së, me datë 14.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Xh.Xh., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore DRK në Gjilan, PKR.nr.292/2016 të datë 02.11.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore DRK në Gjilan, PKR.nr.292/2016 të datë 02.11.2017, i akuzuari Xh.Xh., është shpallur fajtorë për veprën penale, keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së, dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 2 (dy) viteve, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Të akuzuarin e ka obliguar t'i paguajë shpenzimet e procedurë penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 40 €, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh.Xh. av. E.V., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza apo lënda të kthehet në rivendosje.

Prokuroria e Apelit me shkresën PPA/I.nr.39/18 të datës 19.01.2018, ka propozuar që të refuzohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata në kuptim të nenit 390 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit, por nuk u njoftuan Prokurori i Apelit, i akuzuarit, meqenëse të akuzuarit nuk i është shqiptuar dënim me burgim efektiv, prandaj dispozitat e KPPK-së nuk e detyrojnë gjykatën që ti njoftoj palët për seancën e kolegjit.

Gjykata shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimi e ankimuar, ankesën Mbrojtësi i të akuzuarit Xh.Xh. av. E.V., shkresat tjera të lëndës, gjeti se :

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, është e pa bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit pretendon, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 dhe neni 370 par. 4 lidhur me nenin 365 të KPPK-së, se gjykata e shkallës së parë, nuk e ka përpiluar aktgjykimin konform dispozitave të nenit 370 par. 4 lidhur me nenin 365 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së, e ka ndryshuar përmbajtjen e veprimeve inkriminuese të akuzuarit në dispozitiv të aktgjykimit, në krahasim me atë që është paraqitur në dispozitivin e aktakuzës nga ana e prokurorisë, se në vend të fjalëve: “kontrabanduesve të mallrave” ka shënuar fjalët “personave S.H., Xh.S., Xh.S., K.R. dhe N.I.” edhe pse në aktakuzë nuk kanë qenë të shënuar emrat e këtyre personave, se të drejtën për ndryshimin e dispozitivit të aktakuzës e ka vetëm prokuroria. Se në aktgjykimin e ankimuar nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i ka konsideruar të vërtetuara apo të pa vërtetuara dhe nuk ka saktësuar provat kundërthënëse, sepse në dispozitiv nuk përshkruhen qartë veprimet inkriminuese në raport me secilin prej personave që i ka paraqitur si dëshmitar, në arsyetim të aktgjykimit nuk është përshkruar se cilës provë ia ka falur besimin apo nuk ia ka falur besimin dhe në bazë të një vlerësimit të tillë të nxjerrë një vendim të drejtë, se asnjëra nga deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor, nuk argumenton faktin që bisedat telefonike të kenë pasur të bëjnë me kontrabandimin e mallrave. Kurse dëshmia e dëshmitarit Xh.S., e dhënë në prokurori, e cila është lexuar në shqyrtimin gjyqësor, është provë e papranueshme, të njëjtën mbrojtja e ka kundërshtuar, sepse është dhënë pa prezencën e mbrojtjes së të akuzuarit, duke mos pasur mundësi që të kundërshtojë këtë dëshmi në asnjë fazë të procedurës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk qëndrojnë, se nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale të pretenduar në ankesë, e as shkelje të cilat kjo gjykatë i shikon edhe sipas detyrës zyrtare, dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm. Në aktgjykimin e ankimuar janë përshkruar faktet dhe rrethanat që përbejnë figurën e veprës penale dhe aktgjykimi është përpiluar konform nenin 365 par.1 nën.par.1.1 të KPPK. Dispozitivi i aktgjykimit nuk ka kundërthënie ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës, në dispozitiv të aktgjykimit nuk është ndryshuar përmbajtjen e veprimeve inkriminuese të akuzuarit, në atë që është paraqitur në dispozitivin e aktakuzës nga ana e prokurorisë, vetëm se në vend të fjalëve kontrabanduesve të mallrave janë shënuar emrat e personave S.H., Xh.S., Xh.S., K.R. dhe N.I., të cilëve i akuzuari ju ka ndihmuar në transportimin e mallrave duke i njoftuar përmes telefonit, se kur mund të kalojnë me mallra pa u ndalur nga ana e policisë, kurse në arsyetim të aktgjykimit janë përshkruar deklaratat e dëshmitarëve S.H., Xh.S., Xh.S., K.R. dhe N.I., të cilat përputhen me provat materiale të administruara, si me raportin mbi implementimin e masave fshehta të hetimit dhe vëzhgimit- përgjimit të telekomunikimeve të bëra sipas urdhëresave të gjykatës dhe transkriptove të bisedave telefonike. Kurse sa i për ketë pretendimit të mbrojtësit të akuzuarit, se dëshmia e dëshmitarit Xh.S.t e dhënë në prokurori, e cila është lexuar në shqyrtimin gjyqësor, është provë e papranueshme, është i pa bazuar, se gjykata e shkallës se parë ka vepruar konform nenit 338 par, 1 pika 1.1 të KPPK-së, ku parashihen kushtet se kur mund të lexohen deklaratat e personave që nuk kanë mundësi të deklaron në gjykatë, e në rastin konkret dëshmitari Xh.S. edhe për kundër përpjekjeve të gjykatës që i njëjti të sillet në gjykatë, është njoftuar nga policia se jeton në Francë.

Për sa i për ketë bazës ankimore të mbrojtësi të akuzuarit, se me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga gjykata e shkallës se parë, duke e kontestuar mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e shkallës se parë, se dëshmitë e dëshmitarëve S.H., Xh.S., I.I., K.Rr. dhe N.I., nuk argumentojnë asgjë lidhur me favoret se gjëja ju ka bërë i akuzuari këtyre personave gjatë kontrabandimit të mallrave, se nga deklaratat e këtyre personave nuk vërtetohet asnjë element i veprës penale, se provat janë vlerësuar nga gjykata e shkallës në mënyrë të njëanshme pa ndonjë analizë, se me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohet se i akuzuari me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për veti apo tjetrin të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga gjykata e shkallës se parë, pas administrimit të provave materiale, raportit mbi implementimin e masave fshehta të hetimit dhe vëzhgimit-përgjimit të telekomunikimeve dhe dëgjimit të dëshmitarëve dhe të akuzuarit, se nuk është kontestuese se i akuzuari në periudhën kohore prill-maj 2013 në cilësi të personit zyrtar, si polic në vijën kufitare në Kaçanik, duke e shfrytëzuar pozitën zyrtare i ka tejkalluar kompetencat zyrtare, në atë mënyrë që më qëllim që

vetës dhe të tjerëve të ju sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, gjatë vijës kufitare Debellde-Stanqiq, në mënyrë të vazhdueshme përmes numrit të telefonit 044 428 080, ka komunikuar dhe ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me personat S.H., Xh.S., Xh.S., K.R. dhe N.I., për të ju ndihmuar që të transportojnë mallra në mënyrë të kundërligjshme, ashtu që pas implementimit të masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit është vërtetuar një fakt i tillë.

Se nuk është kontestuese se i akuzuari i ka ndihmuar personat S.H., Xh.S., Xh.S., K.R. dhe N.I., gjatë transportimit të mallrave, në vijën kufitare Debellde-Stanqiq, duke i njoftuar për mes telefonit se kur është kufiri i lirë që ata të transportojnë dru dhe gjëra tjera pa leje, ashtu që sipas dëshmitarit Xh.S.n, i akuzuari e ka ndihmuar të transportoj dru pa leje, por pa ndonjë interes, por djalit të akuzuarit i ka dhënë të holla në emër të blerjes së druve në shumë prej 80 €, për 5 m dru, edhe pse vetë është marrë me shitjen e druve, i ka ndihmuar që të i lirohet kamioni kur policia e kishin ndaluar në fshatin Zhegër, e ka njoftuar rreth lëvizjes së policisë në territorin e fshatrave Karadak, kurse nga transkriptet e bisedave telefonike është vërtetuar se i akuzuari për ndihmën që ia ka dhënë Xh.S. ka kërkuar edhe mbushje të telefonit, duke i thënë “në këtë numër të telefonit dërgomi 3(tre) €”, një numër të Z- mobile. I akuzuari me dt. 30.04.2013 me SMS ka komunikuar me Xh.S. dhe nga ai ka kërkuar 300€, gjëja se ja kishte borxh për traktor të cilin ia kishte shitur më herët. Pastaj i akuzuari me dt. 18.05.2013 ka biseduar me telefon nga numri 044-594-581 me K.R. të cilin e pyet se “ku gjindët” dhe ai i përgjigjet se “është në fsh. Binçë” dhe e ka kamionin të ngarkuar me dru të cilit i thotë “se ti vetëm ecë se unë ta qeli rrugën” e pastaj i thotë “fshehu pak se jemi duke ardhur përpjetë”, dhe në të njëjtën datë ka biseduar me N.I. i cili i thotë përmes telefonit “se e kanë zënë policia me dru, është së bashku me vllaun e tij dhe nga policia ka kërkuar që të ndërrohet me vllaun e tij sepse ai ka shumë dënime”, kurse i akuzuari i është përgjigjur “nëse jeni të dy në kamion ndërrohuni”. Për çka ka biseduar me kolegun e tij dhe i ka thënë se personin që e keni zënë me dru i ndihmon si informator dhe ka kërkuar nga kolegu i tij që të ndërrohet shoferi, kurse nga S.H., i cili është marrë me prerjen dhe shitjen ilegale të drunjtëve, i akuzuari ka kërkuar 100 € për pagesën e një kredie, i cili nuk ia ka dhënë me arsyetim se nuk ka pasur para. Të gjitha këto gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar përmes implementimit të masave fshehta të hetimit dhe vëzhgimit-përgjimit të telekomunikimeve të bëra sipas urdhëresave të gjykatës dhe transkriptove të bisedave telefonike. Në këtë mënyrë i akuzuari i ka tejkaluar autorizimet e tija si pjesëtar i Policisë së Kosovës, duke iu krijuar favore personave të cekur më lartë në transportimin e mallrave, me qëllim që për vete apo të tjerët të përfitojnë dobi të kundërligjshme pasurore, duke iu kërkuar para, mbushje të telefonit, numër të telefonit, në mënyrë që personave të përmendur më lartë t’iu mundësohet transportimi i mallrave dhe mos të ndalohen nga ana e policisë.

Gjykata e Apelit, gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e aprovon, sepse e njëjta është e bazuar në provat që i ka administruar gjykata e shkallës së parë e që gjinden në shkresat e lëndës, si dëshmitë e dëshmitarëve të cekur më lartë, përgjimet e bisedave telefonike nga të cilat është vërtetuar se i akuzuari vazhdimisht ka biseduar me dëshmitarët duke i informuar se kur mund të transportojnë mallin pa u ndaluar nga ana e policisë, e që as i akuzuari nuk e ka mohuar se ka pasur biseda telefonike me këta persona, se i ka kërkuar para S.H. për pagesën e kredisë i cili nuk ia ka dhënë, Xh.S. ja ka kërkuar parat të cilat gjëja ia kishte borxh, kurse K.R. dhe N.I.n i ka pasur informator për kontrabandim me lopë që janë bartur nga fsh. Dobellde.

Nga arsyet që u thanë më lartë, kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit, se me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar, se gjykata e shkallës së parë drejto ka vërtetuar gjendje faktike, e cila është e pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Mbrojtja pretendon se si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, ka ardhur deri te zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale, keqpërdorim i pozitës apo autoriteti zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për të cilën veprën penale e ka shpallur fajtor.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, konstaton se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, janë të pa bazuara, se me provat e administruara është vërtetuar në mënyrë të pa dyshimtë fajësia e të akuzuarit, se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale nga neni 422 par. 1 të KPK,

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, sipas ankesës se mbrojtësit të akuzuarit, kjo gjykatë vlerëson, se gjykata e shkallës së parë drejto i ka vlerësuar rrethana që ndikojnë në llojit dhe lartësisë së dënimit, kurse mbrojtja nuk çeket ndonjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që dënimi të jetë më i butë, apo i akuzuari të lirohet nga akuza.

Gjykata e Apelit gjënë, se gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit, ka pasur parasysh rrethanat që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese ka marrë, sjelljen e të akuzuarit në gjykatë, se më parë nuk ishte i dënuar, se është familjar dhe babë i katër fëmijëve, të cilat rrethana i aprovon edhe kjo gjykatë, kurse si rrethana rënduese ka marrë shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethana e përmendura, rrethanat e rastit konkret del se dënimi që iu është shqiptuar të akuzuarit për veprën penale nga neni 422 par. 1 të KPK-së, është në harmoni me inenzitetetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës se kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se ky dënim duhet të jetë në shërbim të preventivës së përgjithshme, forcimit të moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës se qytetarëve dhe është në pajtueshmëri me kërkesat për sigurinë pasurisë shoqërore, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënimin ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit në bazë të nenit 401 të KPPK-së.

GJYKATA E APLEIT E KOSOVËS

PAKR.nr. 32/18 i datës 14.03.2018

Procesmbajtësi

Antarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Perparim Zeka

Tonka Berishaj

1. Have Haliti

2. Fillim Skoro